

Manuela Imeraj është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 2002 dhe ka një diplomë Master në “Studime Europiane”, Shkolla e Studimeve Pasuniversitare, Universiteti i Tiranës, në vitin 2008 dhe po në të njëjtin vit është pajisur me licencën “Avokat”. Gjatë periudhës janar – prill 2006 ajo ka ndjekur Programin e Liderimit të “Studimeve të Avancuara të Sigurisë”, në Kolegjin Ndërkombëtar për Studime të Sigurisë, George C. Marshall Center, Garmisch – Panterkirchen, Gjermani. Që prej mbarimit të studimeve në vitin 2002, ka punuar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ka qenë eksperte në bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale ndërmjet autoriteteve gjyqësore vendase dhe të huaja, duke u marrë me çështjet e ekstradimit, asistencën e ndërsjellë juridike, ekipet e përbashkëta hetimore në rastet e krimit të organizuar, transferimin e të burgosurve dhe të procedimeve penale etj. Ka punuar disa vite me kohë të pjesshme si Pedagoge në Departamentin e Gazetarisë, Fakulteti Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës. Ajo ka qenë gjithashtu e përfshirë si eksperte afatshkurtër për projekte të ndryshme të zbatuara nga Ambasada Britanike dhe Zyra e Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillim GIZ Albania dhe ka qenë pjesë e grupeve të ndryshme ndër-institucionale të punës për hartimin e legjislacionit në fushën penale. Që prej vitit 2021, Znj. Imeraj është punësuar në Avokaturën e Shtetit në pozicionin Drejtuese e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar. Kjo Zyrë është struktura përgjegjëse për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit Shqiptar pranë gjykatave të huaja, ndërkombëtare, arbitrazhit ndërkombëtar dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor ose mbikëqyrës.